



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT

NUMERI I PROTOKOLLIT
Vitet
2020
Nr. 1952/3
Data 25.11.2020

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 19. 11. 2020

VENDIM

Nr. 54, datë 19. 11. 2020

**PËR PAGESËN E MBINGARKESËS SË STAFIT AKADEMIK PËR VITIN
AKADEMIK 2019- 2020**

Në mbështetje të nenit 49, pika 1 shkronja a, ë të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 25 pika (a), ë) dhe II), të Statutit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 29 datë 10. 09. 2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*", propozimit të Administratorit të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë me shkresën nr. 1755/2 prot, datë 03. 11. 2020 si dhe shkresës së Zv/ Rektorit Akademik nr. 1858 prot datë 11. 11. 2020, në mbledhjen e datës 19. 11. 2020, vendimin e Senatit Akademik nr. 99 datë 28. 10. 2020 "Propozim bordit të administrimit të ngarkesës mësimore të realizuar për stafin akademik për vitin akademik 2019- 2020", Bordi i Administrimit

KONSTATON SE:

Pra në Bordit të Administrimit është depozituar nga Administratori i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë për shqyrtim shkresa nr. 1755/2 prot, datë 03. 11. 2020 si dhe relacioni i Zv/ Rektorit Akademik nr. 1858 prot datë 11. 11. 2020 me anë të së cilës kërkohet të paguhet mbingarkesa e stafit akademik për vitin akademik 2019-2020. Në relacionin e Administratorit arsyehet se në buxhetin e miratuar nga organet koolegjiale të Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë janë buxhetuar 36,763 orë me efekt financiar 32,476,000 lekë.

Vihet re një diferencë prej 6,673 orë midis orëve faktike dhe atyre të buxhetuara, pra një tejkalim të orëve të miratuara me buxhetin e vitit 2020 me vlerë financiare 6,663,705 lekë.

Relacionit të Administratorit i janë bashkëlidhur shkresa nr. 1755/1 prot datë 03. 11. 2020 e Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, vendimi i Senatit Akademik nr. 99 datë 28. 10. 2020 "Propozim bordit të administrimit të ngarkesës mësimore të realizuar për stafin akademik për vitin akademik 2019- 2020", shkresa e Zv/ Rektorit Akademik nr. 1755 prot datë 29. 10. 2020 ku përcillet pasqyra përmbledhëse e mbingarkesës mësimore të personelin akademik



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
BORDI I ADMINISTRIMIT


me kohë të plotë. Këto të dhëna tregojnë për një planifikim jo efektiv dhe monitorim jo të drejtë. Kjo situatë çon në përdorim joefektiv të buxhetit të universitetit.

Referuar nenit 2, pikë 1 e Udhëzimit nr. 29 datë, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionete arsimit të lartë" "Ngarkesa mësimore vjetore për personelin akademik në institucionet e arsimit të lartë" citon se : "Çdo orë e realizuar në auditor mbi këtë përcaktim është orë suplementare e cila përlllogaritet sipas koeficientëve dhe paguhet e plotë nga IAL-të . Orët suplementare në auditor nuk mund të jenë më shumë se 200 orë. Në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë.

Në realcionin justifikues të Zv/ Rektorit Akademik dhe Drejtorisë së Edukimit të Ciklit të parë dhe të dytë studimit sqarohen për çdo fakultet planifikimi dhe realizimi faktik i orëve mësimore në auditor dhe jashtë tij. Bashkëlidhur këtij relacioni gjendet dokumentacioni i shkresave justifikuese e mbingarkesës mbi 200 orë, megjithatë ky dokumentacion nuk është paraqitur nga të gjithë drejtuesit e njësive bazë dhe atyre kryesore (por vetëm nga ana e FE dhe disa njësi bazë të FSHH), duke treguar edhe njëherë mungesën e një procedure të unifikuar të cilën Bordi e ka kërkuar në disa prej vendimeve të tij të viteve të mëparshme.

Duke marrë në konsideratë udhëzimin e MASR nr. 29 i cili lejon tejkalim vetëm në raste specifike, auditin e MASR në "Raporti Përfundimtar i Auditit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, mbi auditimin e zhvilluar në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, dërguar me me shkresën Nr. 4609/4 prot., datë 19. 07. 2018, me objekt, "Vlerësimi i sistemeve të kontrollove të brendshëm, i riskut dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin në arritjen e objektivave" periudhën 01. 12. 2016 deri në 30. 04. 2018, Auditimin e KLSH miratuar me Vendimin nr. 163, datë 27.12.2019 "Për Auditimin e ushtruar në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë "Mbi Auditimin Financiar" për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2018", në të cilin konstatohet se pavarësisht numrit në rënie të studentëve ka një rritje të stafit akademik dhe shpenzimeve, por dhe se "përveç rritjes në vlerë absolute tejkalimi në masë të gjerë (thuajse e plotë) nga ana e stafit akademik të orëve, mbingarkesa e normuar me akte ligjore në shumicën e rasteve është justifikuar vetëm nga vetëdeklarimet e përcjella nga fakultetet, por nga institucioni nuk rezultojnë verifikime lidhur me këto deklarime nëpërmjet mekanizmave kontrollues". Në raportin e vet KLSH ka dalë me Rekomandimin se "Nga ana e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, të merren masat për verifikimin e vazhdueshëm të ngarkesave individuale për personelin akademik prej planifikimit, ngarkesave mësimore të kryera në fakt dhe të paraqitura nëpërmjet fakultetit respektiv, dokumentimin dhe produktin e punës kërkimore shkencore si dhe detyrave mbështetëse, kjo për të rritur efektivitetin dhe eficientën e institucionit si dhe eliminimin e pagesave të panevojshme nga ana e tij", meqënëse çështja e ngarkesës dhe mbingarkesës është një çështje akademike dhe në bazë të LAL u përket për diskutim, monitorim, vendimarrje dhe çertifikim autoriteteve dhe organeve përgjegjës për anën akademike (Rektor, Senat), lind nevoja urgjente për diskutim dhe vendimarrje nga ana e tyre.

Këto konstatime dhe rekomandime BA i ka lënë dhe në vendimet e tij të mëparshme, ku risillet këtu në vëmendje Vendimi nr. 47 datë 17.10.2019 "Mbi likuidimin e orëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

suplementare", në të cilin BA ka konstatuar se "ka njësi baze në të cilat janë ngarkuar deri në 100 orë shtesë në auditor (si rast specifik) mbi 200 orëshin e mbingarkesës, pothuasje i gjithë stafi akademik anëtarë të kësaj njësie, por megjithatë BA nuk mund ti hyj logjikës akademike nëse mund të konsiderohet kjo situatë si raste specifike apo situatë e përgjithshme, pasi në bazë të parashikimit të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, ky vlerësim dhe përgjegjësia i përket autoriteteve dhe organeve kolegjiale përgjegjës për anën akademike. Rasteve specifike i shtohet dhe ngarkesë e pagueshme si orë jashtë auditorit në ndihmë të procesit mësimor (praktika, udhëheqje teza diplomash etj), duke krijuar një situatë ku pedagogë tejkalojnë me 2 apo 3 fish ngarkesën normale të parashikuar nga Udhëzimi nr. 29, datë 10.09.2018, ndërkohë që ka ekzistuar mundësia e një shpërndarje më të drejtë të mbingarkesës brenda njësive bazë, në të cilat rezulton se ka staf akademik me një mbingarkesë të ulët, kjo me qëllim dhe ruajtjen e cilësisë së mësimdhënjes.

Me qëllim rinospërsëritjen e kësaj situatë dhe uljen e efekteve financiare, Bordi Administrimit pa ndërhyrë në kompetencat e organeve të tjera dhe pa hequr dorë nga përgjegjësia e tij, por duke marrë në konsideratë se kjo situatë mund që në të ardhmen të çënoje qëndrueshmerine financiare të Universitetit, në vendimin 47 datë 17.10.2019 ka rekomanduar: krijimin e një mekanizmi kontrolli për sa i përket përlogaritjes së ngarkesës në fillim të vitit konform me programet akademike të miratuara, dhe realizimit të saj përgjate vitit. Krijimin e një mekanizmi dhe vendosjen e filtrave të duhur nëpërmjet drejtuesve të njësive kryesore dhe bazë, përgjegjësve të seksioneve përkatëse si dhe drejtorive përgjegjëse në Rektorat, për kontrollin dhe shpërndarjen e orëve dhe mbingarkesës në auditor dhe jashtë auditorit, në mënyrë sa më të balancuar tek të gjithë pedagogët, duke evituar tejkalimin e orëve të cilat udhëzimi parashikon qartësisht, dhe duke ruajtur në këtë mënyrë cilësinë në mësimdhënie.

Lind nevoja e bërjes së analizës së situatës lidhur me nivelin e lartë të mbingarkesës së raportuar e cila jo gjithmonë lidhet me numrin e studentëve por me planifikim, menaxhimin dhe shpërndarjen e orëve. Në fakt vihet re se vendimi nr. 99 datë 28. 10. 2020 i Senatit Akademik është një propozim për pagesën e mbingarkesës në terma shumë të përgjithshëm, i marrë në mungesën të një analize financiare të paraqitur më vonë nga ana e administratorit, në disa raste në mungesë të relacioneve të përgjegjësve të disa njësive bazë për staf akademik që ka tejkaluar 200 orëshin e mbingarkesës, si rast specifik, si dhe pa marrë parasysh parashikimin e pikës 3 e Dispozita të fundit e Udhëzimit nr. 29 e cila citon: "Çdo angazhim i personelit akademik në IAL në veprimtari të pagueshme dhe që nuk është parashikuar dhe miratuar në buxhetin e IAL-së, duhet marrë përpara ushtrimin të veprimtarisë miratimin e bordit të administrimit të IAL-së".

Nga sa më sipër BA kërkon nga Senati Akademik si organi koolegjial më i lartë akademik, të cilit i takon certifikimi nga ana akademike e orëve të ngarkesës mësimore, në mbështetje kjo dhe të nenit 19 të pika m) dhe n) e Statuti të UV- së, SA garanton realizimin e objektivit për një universitet të bazuar në kërkimin shkencor, si dhe krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore- shkencore të personelit akademik, ngritjen e strukturave kontrolluese - monitoruese dhe gjetjen e mekanizmit të shpërndarjes së orëve në mënyrë sa më efektive, të cilat konform dhe rekomandimeve të lëna nga KLSH, Auditit i MARS, rekomandimet e lëna në dy auditimet e bëra nga Njësia e Auditit të brendshëm dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

vendimet e mëparshme të BA, të kryejë verifikimin e ligjshmërisë së gjithë dokumentacionit të paraqitur nga departamentet dhe fakultetet, mundësin fizike të kryerjes së këtyre orëve, veprimtarin kërkimore-shkencore të stafit, ngarkesën administrative të tyre, kontrollin e praktikave mësimore, sa janë realizuar dhe sa realisht stafi akademik ka asistuar në këto praktika, orët e udhëheqjes së diplomave, etj

Nga sa më sipër Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19. 11. 2020.

VENDOSI:

1. Referuar shkresës së Administratorit nr. 1755/2 prot, datë 03. 11. 2020 si dhe shkresës së Zv/ Rektorit Akademik nr. 1858 prot datë 11. 11. 2020, të pranojë pjesërisht propozimin e Senatit të shprehur me vendimin nr. 99, datë 28. 10. 2020, dhe të ngarkojë Administratorin të vazhdojë ekzekutimin e pagesës së mbingarkesës sipas buxhetit të miratuar nga organet koolegjiale Senat Akademik dhe Bord i Administrimi për vitin buxhetor 2020, për 36,763 orë me efekt financiar 32,476,000 lekë.
2. Ti kërkojë Senatit Akademik si autoriteti më i lartë akademik dhe *përgjegjës për krijimin e mekanizmave për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik*, të kryejë verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga departamentet si dhe të realizimit orëve, dhe të shprehet me Vendim për diferencën e 6,673 orëve faktike që kanë tejkaluar parashikimet.
3. Efekti financiar do të përballohet nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.
5. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Senatit Akademik të UV-së.
6. Bashkëlidhur këtij vendimi shkresa e Administratorit nr. 1755/2 prot, datë 03. 11. 2020 si dhe shkresës së Zv/ Rektorit Akademik nr. 1858 prot datë 11. 11. 2020.

KRYETAR

Dr. Ervis MOCKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ZV/REKTORI AKADEMIK

Nr. 1855..... Prot.

Vlorë më, 11 . 11 .2020

LËNDA: DËRGOHET RELACION PËR REALIZIMIN E NGARKESAVE MËSIMORE
TË STAFIT EFEKTIV PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020.

Z. ERVIS MOCKA

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU:

Bashkëlidhur ju përcjellim relacionin mbi realizimin e ngarkesave mësimore
të stafit efektiv për vitin akademik 2019-2020.

Relacioni shoqërohet me Tabelat analitike të realizimit të ngarkesave si dhe
shkresat shoqëruese të FE dhe FSHH për mbingarkesat mbi 200 orë në auditor.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

Zv/REKTORI

Prof. As. Frosina Londo Qyrdeti

**RELACION MBI ANGAZHIMIN E PERSONELIT AKADEMIK EFEKTIV PER VITIN
AKADEMIK 2019-2020.**

Gjatë vitit akademik 2019-2020 në mësimdhënie në Universitetin "Ismail Qemli" Vlorë janë angazhuar 296 staf akademik gjithsej, nga të cilët 204 staf efektiv dhe 92 staf me kohë të pjesësoshme dhe staf i ftuar.

1. Planifikimi i ngarkesës së stafit efektiv 2019-2020.

Në fillim të vitit akademik 2019-2020 ishin planifikuar të angazhoheshin në procesin mësimor 209 staf efektiv sipas fakulteteve dhe departamenteve:

Ngarkesa totale e planifikuar në auditor është 66046.2 ore dhe për ngarkesën jashtë auditorit vetëm FSHTN ka bërë një planifikim paraprak.

PLANIFIKIMI I NGARKESES 2019-2020					
Fakulteti/Departamenti	Nr.stafit efektiv	Norma (ore)	Ngarkesa në auditor	Jashtë auditorit	Totali i ngarkesës së planifikuar
FSH					
Dep.Infermierise	12	2120	4598	0	4598
Dep.Kujdesit shëndetësor	11	1825	4023.2	0	4023.2
Qendra kerkimore-shkencore	11	1875	3820	0	3820
Shuma	34	5820	12441.2	0	12441.2
FE					
Dep.Biznesit	14	2205	4915	0	4915
Dep.i Ekonomiksit	7	1015	2895	0	2895
Dep.Finances dhe kontabilitetit	10	1635	4155	0	4155
Shuma	31	4855	11965	0	11965
FSHTN					
Dep.Shkencave kompjuterike	13	2178	4485	275	4760
Dep.Fizikes	7	1142	1395	0	1395
Dep.Biologjise	10	1447.25	3187	402.5	3589.5

Stefan

Dep.Matematikes	15	2520	3195	250	3445
Dep.Kimise	7	895.5	1485	635	2120
Dep.Inxhinierive dhe teknologjise	11	1790	3585	180	3765
Dep.Shkencave detare	7	1105	2175		2175
Shuma	70	11077.8	19507	1742.5	21249.5
FSHH					
Dep.Gjuheve te huaja	24	4030	7470	0	7470
Dep.Drejtewise	19	2755.5	5830	0	5830
Dep.Edukimit	18	2800	5328	0	5328
Dep.Gjuhes dhe letersise	13	1755	3505	0	3505
Shuma	74	11340.5	22133	0	22133
Totali	209	33093.3	66046.2	1742.5	67788.7

Keshtu,nga ana e fakulteteve jane paraqitur dokumentacioni me evidencat dhe permblidheset e ngarkesave te planifikuara per vitin akademik 2019-2020.Nga tabela e mesiperme rezulton se :

1.Fakulteti i Shendetit ka planifikuar per stafin efektiv gjithsej 12441 ore te cilat mbulojne ngarkesen ne auditor .Gjithsej jane planifikuar 34 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Norma totale e tyre eshte 5820 ore .

Mbingarkesa mesatare e planifikuar eshte 214 % e normes mesimore.

Dep.Infermierise	217 %
Dep.Kujdesit shendetesor	221 %
Qendra kerkimore-shkencore	204 %

2.Fakulteti i Ekonomise ka planifikuar per stafin efektiv gjithsej 11965 ore te cilat mbulojne ngarkesen ne auditor .Gjithsej jane planifikuar 31 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Norma totale e tyre eshte 4855 ore .

Mbingarkesa mesatare e planifikuar eshte 246 % e normes mesimore.

Dep.Biznesit	223 %
Dep.Ekonomiksit	285 %
Dep.Fin-kontabilitet	254 %

Arshinaj

3.Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka planifikuar per stafin efektiv gjithsej 21249.5 ore nga te cilat 19507 ore ne auditor dhe 1743 ore jashte auditorit. Gjithsej jane planifikuar 70 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Norma totale e tyre eshte 11078 ore .
Mbingarkesa mesatare e planifikuar ne auditor eshte 178 % e normes mesimore.

Dep.Shkencave kompjuterike	206 %
Dep.Fizikes	122 %
Dep.Biologjise	220 %
Dep.Matematikes	127 %
Dep.Kimise	166 %
Dep.Inxhinierive dhe teknologjise	200 %
Dep.Shkencave detare	197 %

4.Fakulteti i Shkencave Humane ka planifikuar per stafin efektiv gjithsej 22133 ore ne auditor dhe. Gjithsej jane planifikuar 74 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Norma totale e tyre eshte 11341 ore .Mbingarkesa mesatare e planifikuar ne auditor eshte 195 % e normes mesimore.

Dep.Gjuheve te huaja	185 %
Dep.Drejtesise	212 %
Dep.Edukimit	190 %
Dep.Gjuhes dhe letersise	200 %

Prokuror

2.Realizimi i ngarkeses 2019-2020 nga stafi efektiv.

REALIZIMI I NGARKESES 2019-2020					
Fakulteti/Departamenti	Nr.stafit efektiv	Norma (ore)	Ngarkesa e realizuar ne auditor	Jashte auditorit	Totali i ngarkeses se realizuar
FSH					
Dep.Infermierise	12	2120	3578	865	4443
Dep.Kujdesit shendetesor	11	1825	3113	877.5	3990.5
Qendra kerkimore-shkencore	11	1875	3668	395	4063
Shuma	34	5820	10359	2137.5	12496.5
FE					
Dep.Biznesit	14	2205	5095	1080	6175
Dep.i Ekonomiksit	7	1015	2895	360	3255
Dep.Finances dhe kontabilitetit	9	1470	4110	1450	5560
Shuma	30	4690	12100	2890	14990
FSHTN					
Dep.Shkencave kompjuterike	13	2178	4524	315	4839
Dep.Fizikes	7	1142	1540	40	1580
Dep.Biologjise	9	1357.25	2882	727	3609
Dep.Matematikes	15	2520	3698	270	3968
Dep.Kimise	7	895.5	1725	460	2185
Dep.Inxhinierive dhe teknologjise	10	1595	3354	150	3504
Dep.Shkencave detare	7	1105	2160	375	2535
Shuma	68	10792.75	19883	2337	22220
FSHH					
Dep.Gjuheve te huaja	22	3640	7155	510	7665
Dep.Drejtewise	19	2755.5	5860	290	6150
Dep.Edukimit	18	2800	5613	1425	7038
Dep.Gjuhes dhe letersise	13	1755	3705	1440	5145
Shuma	72	10950.5	22333	3665	25998
Totali	204	32253.25	64675	11029.5	75704.5

V. B. B. B.

1.Fakulteti i Shendetit ka realizuar nga stafi efektiv gjithsej 12496.5 ore te cilat mbulojne ngarkesen ne auditor 10359 ore dhe 2137.5 ore jashte auditorit. Gjithsej, jane angazhuar 34 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Mbingarkesa prej 4539 ore jane mbingarkese ne auditor. Ngarkesa mesatare e realizuar ne auditor eshte 178 % si fakultet dhe sipas departamenteve:

Dep.Infermierise	168.8 %
Dep.Kujdesit shendetesor	170.6 %
Qendra kerkimore-shkencore	195.6 %

Mesatarja e ngarkeses ne auditor eshte 305 ore,min=165 ore dhe max = 435 ore ne auditor. Ngarkesa maximale ne auditor dhe jashte tij eshte = 435 ore.

2.Fakulteti i Ekonomise ka realizuar nga stafi efektiv gjithsej 14990 ore te cilat mbulojne ngarkesen ne auditor 12100 ore dhe 2890 ore jashte auditorit. Gjithsej, jane angazhuar 30 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Mbingarkesa prej 7410 ore jane mbingarkese ne auditor. Ngarkesa mesatare e realizuar ne auditor eshte 258 % per FE dhe sipas departamenteve:

Dep.Biznesit	231.1 %
Dep.Ekonomiksit	285.2 %
Dep.Fin-kontabilitet	279.6 %

Mesatarja e ngarkeses ne auditor eshte 403 ore,min=295 ore dhe max = 480 ore ne auditor. Ngarkesa maximale ne auditor dhe jashte tij eshte = 660 ore.

3.Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore ka realizuar nga stafi efektiv gjithsej 22220 ore te cilat mbulojne ngarkesen ne auditor 19883 ore dhe 2337 ore jashte auditorit. Gjithsej, jane angazhuar 68 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Mbingarkesa prej 9090 ore jane mbingarkese ne auditor.

Ngarkesa mesatare e realizuar ne auditor eshte 184.2 % si fakultet dhe sipas departamenteve:

Dep.Shkencave kompjuterike	207.7 %
Dep.Fizikes	134.9 %

Busha

Dep.Biologjise	212.3 %
Dep.Matematikes	146.8 %
Dep.Kimise	192.6 %
Dep.Inxhinierive dhe teknologjise	187.4 %
Dep.Shkencave detare	195.5 %

Mesatarja e ngarkeses ne auditor eshte 288 ore, min=54 ore dhe max = 414 ore ne auditor.
Ngarkesa maximale ne auditor dhe jashte tij eshte = 645 ore.

4.Fakulteti i Shkencave Humane ka realizuar nga stafi efektiv gjithsej 25998 ore te cilat mbulojne ngarkesen ne auditor 22333 ore dhe 3665 ore jashte auditorit. Gjithsej, jane angazhuar 72 pedagoge efektive ne mesimdhenie .Mbingarkesa prej 11383 ore jane mbingarkese ne auditor.
Ngarkesa mesatare e realizuar ne auditor eshte 204 %.si fakultet dhe sipas departamenteve:

Dep.Gjuheve te huaja	196.6 %
Dep.Drejtesise	212.7 %
Dep.Edukimit	200.5 %
Dep.Gjuhes dhe letersise	211.1 %

Mesatarja e ngarkeses ne auditor eshte 310 ore, min=90 ore dhe max = 495 ore ne auditor.
Ngarkesa maximale ne auditor dhe jashte tij eshte = 680 ore

3. Tejkalmimi mbi 200 ore ne auditor sipas fakulteteve /departamenteve.

Ne Fakultetin e Shendetit vetem 8 pedagoge kane tejkalkuar mbingarkesen prej 200 ore ne auditor me nga 3 deri ne 40 ore (2 ne Dep e Infermierise,3 ne Dep. Kujdesit Shendetesor dhe 3 ne Q.K.SH)


Ne FE jane 23 pedagoge qe tejkalojne mbingarkesen 200 ore ne auditor nga 10 ne 130 ore (7 ne Dep.e Biznesit,7 ne Dep e Ekonomiksit dhe 9 ne Dep.Finance-Kontabilitet).

Handwritten signature

Ne FSHTN jane 17 pedagoge qe tejkalojne mbingarkesen prej 200 ore ne auditor nga 2 deri ne 46 ore (6 ne Dep e Shkencave Kompjuterike, 2 ne Dep.Shkencave Detare,3 ne Dep.e Biologjise,4 ne Dep e Inxhinierise dhe teknologjise,2 ne Dep e Kimise).


Ne FSHH jane 15 pedagoge qe tejkalojne mbingarkesen 200 ore ne auditor nga 3 deri ne 130 ore(3 ne Dep.Gjuhe-letersise, 6 ne Dep e Drejtesise,4 ne Dep.e Gjuheve te huaja dhe 2 ne Dep. E Edukimit).

Shperndarja e ngarkeses sipas departamenteve



Shpete 1'

Mbingarkesa ne auditor



Bashkelidhur ketij relacioni edhe Tabelat analitike te realizimit te ngarkeses sipas departamenteve si dhe shkresat justifikuese te mbingarkeses mbi 200 ore per FE me nr.1157 dt 24.07.2020 dhe FSHH me nr.1732 dt 26.10.2020 dhe nr.1535/2 dt 13.10.2020.

Drejtores e Edukimit

Alberta Breshanaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEKANI

157

24.07

Nr. 71 / 12 prot.

Vlorë, më 24.07.2020

Lënda: Shkresë Përcjellëse e realizimit të Ngarkesës Mësimore Vjetore dhe Realizimit të Kohës Vjetore të Punës për Vitin Akademik 2019 – 2020, për Personelin Akademik me Kohë të Plotë, Fakulteti i Ekonomisë.

PROF. DR. ROLAND ZISI

Rektor

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë


I nderuar Zoti Rektor,

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", bashkëlidhur po ju përcjellim Realizimin e Ngarkesës Mësimore Vjetore dhe Realizimit të Kohës Vjetore të Punës për Vitin Akademik 2019 – 2020, për Personelin Akademik me Kohë të Plotë, Fakulteti i Ekonomisë.

Duke Ju falenderuar,

DEKANI I FAKULTETIT TË EKONOMISË

Prof. Dr. Albert Qarri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT**

Nr. 77/4 Prot.

Vlorë, më 23.04 2020

Lënda: Shkresë Përcjellëse e realizimit të ngarkesës mësimore si dhe realizimit të kohës së punës, për vitin akademik 2019 – 2020, nga stafi akademik me kohë të plotë i Departamentit të Ekonomiksit, Fakulteti i Ekonomisë

**DEKANIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË,
PROF.DR. ALBERT QARRI**

I nderuar Z. Dekan!

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Udhëzimit Nr.29 dt. 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë" të MASR, Udhëzimit Nr 37, datë 04.12.2018 "Për një ndryshim në Udhëzimin Nr 29, datë 10.09.2018" të MASR, të Statutit dhe të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në zbatim të shkresës "Mbi angazhimin e personelit akademik në programet e studimit për vitin akademik 2019-2020" Nr 1171/1 Prot. Datë 01.10.2019 të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë Prof.Dr. Roland Zisi, referuar mbledhjeve të njëpasnjëshme të Departamentit të Ekonomiksit në lidhje me shpërndarjen e ngarkesës mësimore si dhe orarin mësimor, referuar Vendimit Nr 211, datë 03.12.2019 "Për Emërim Personeli Akademik" të Rektorit të UV, përcjellë me anë të shkresës "Përcjellje Vendimi" të Drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore me Nr. 1623/10 Prot., dt. 05.12.2019; si dhe referuar Vendimit Nr 216, datë 11.12.2019 "Për Emërim Personeli Akademik i Ftuar" të Rektorit të UV, përcjellë me anë të shkresës "Përcjellje Vendimi" të Drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore me Nr. 1711/1 Prot., dt. 12.12.2019, gjithashtu referuar shkresave:

- "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore finale për vitin akademik 2019-2020" me nr 188/3 prot, datë 13/12/2019,
- "Përcjellje e Ngarkesës Mësimore Finale, për personelin akademik me kohë të plotë, evidencave personale dhe përmbledhëse për planifikimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik me kohë të plotë, si dhe orarin mësimor final për sezonin Vjeshtë 2019, të Fakultetit të Ekonomisë për vitin 2019 - 2020" me Nr. 190/3 Prot , datë 18/12/2020 të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë



UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT

- "Shkresë Përcjellëse e evidencave individuale për realizimin e kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020 për stafin akademik me kohë të plotë të Departamentit të Ekonomiksit" me Nr. 77/ Prot , datë 23.07.2019, të Drejtueses së Departamentit të Ekonomiksit.
- "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore provizore për vitin akademik 2019-2020" me nr 188 prot, datë 11/10/2019,
- "Përcjellje evidencave përmbledhëse për planifikimin e organizimit të kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020" me Nr. 190/2 Prot , datë 05/11/2019 të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë
- "Shkresë Përcjellëse e Ngarkesës Mësimore Provizore Vjetore, për Vitin Akademik 2019-2020" me Nr. 190 Prot , datë 11/10/2019 të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë

përcjellim për miratim dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme për pagesat e mbingarkesave mësimore:

- Shkresën "Realizimi i Ngarkesës Mësimore Vjetore për personelin akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2019-2020, Cikli i Parë i Studimeve Bachelor, si dhe Cikli i Dytë i Studimeve Master, i Departamentit të Ekonomiksit.
- Shkresën "Evidencë përmbledhëse e Departamentit të Ekonomiksit për realizimin e shpërndarjes së kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019 – 2020"

Për personelin akademik që tejkalon mbingarkesën mësimore në auditor mbi 200 orë për vitin akademik 2019-2020, është marrë miratimi për mbingarkesën mësimore në auditor të paguar mbi 200 orë, në shkresën "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore provizore për vitin akademik 2019-2020" me nr 188 prot, datë 11/10/2019 si dhe përmes:

- "Shkresë Përcjellëse e Ngarkesës Mësimore Provizore Vjetore, për Vitin Akademik 2019-2020" me Nr. 190 Prot , datë 11/10/2019 të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë

Për personelin akademik që tejkalon mbingarkesën mësimore në auditor mbi 200 orë është marrë miratim edhe bazuar në:

- Sipas gërmës a) të Udhëzimit Nr 37, datë 04.12.2018 asnjë prej pedagogëve nuk ka më shumë se tre lëndë në një semestër.
- Pedagogët që mbulojnë orët e mësimërme janë të kualifikuar dhe specializuar në fushën e mësimdhënies dhe kanë një eksperiencë shumëvjeçare në të.
- Impenjimi dhe përgjegjshmëria e personelit efektiv është shumë e lartë.
- Përbushet raporti student-pedagog sipas përcaktimeve ligjore. (V.K.M nr. 418 datë 10.05.2017)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I EKONOMIKSIT**

- Regjistrimet e reduktuara të studentëve në vit të parë, për disa vite me radhë, kanë ulur numrin e kurseve dhe grupeve mësimore, duke shkaktuar rënie në ngarkesën mësimore që mbulon çdo department. Jemi kështu në kushtet e rasteve specifike të Udhëzimit Nr.29 dt. 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë" të MASR, Kreu II Pika 1, ku thotë: në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe me miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TE EKONOMIKSIT

Dr. Klaudja Guga



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

Nr. Prot. 44/5

Vlorë, më 23.07.2020

Lënda: Shkresë Përcjellëse e realizimit të Ngarkesës Mësimore Vjetore dhe Realizimit të Kohës Vjetore të Punës për Vitin Akademik 2019 – 2020, për Personelin Akademik me Kohë të Plotë, Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë

DEKANIT TË FAKULTETIT TË EKONOMISË,
PROF.DR. ALBERT QARRI

Në mbështetje të ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Udhëzimit Nr.29 dt. 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë" të MASR, Udhëzimit Nr 37, datë 04.12.2018 "për një ndryshim në Udhëzimin Nr 29, datë 10.09.2018" të MASR, të Statutit dhe të Rregullores së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si dhe:

- në zbatim të shkresës "Mbi angazhimin e personelit akademik në programet e studimit për vitin akademik 2019-2020" Nr 1171/1 Prot. Datë 01.10.2019 të Rektorit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë Prof. Dr Roland Zisi,
- referuar shkresës "Kërkesë për personel akademik me kontratë me kohë të pjesshme dhe me kontratë 1(një) vjecare", me nr 197/9 prot, datë 18/10/2019,
- shkresës "Propozim për personel akademik të ftuar", me nr 197/2 prot, datë 17/10/2019,
- shkresës "Propozim për personel akademik të ftuar për semestrin Vjeshtë 2019" te Dekanit të FE me Nr 197/30 Prot, datë 18.11.2019,
- referuar Vendimit Nr 208, datë 22.11.2019 "Për Riemërim Personeli Akademik" të Rektorit të UV,
- referuar Vendimit Nr 206, datë 20.11.2019 "Për Emërim Personeli Akademik i Ftuar" të Rektorit të UV, për semestrin Vjeshtë 2019, përcjellë me shkresën "Përcjellje vendimesh" me Nr 1623/2 Prot, datë 22.11.2019, të Drejtorit Eloina Tozaj të Drejtorisë së komunikimit dhe Burimeve Njerëzore,



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

- referuar Vendimit Nr 210, datë 26.11.2019 "Për Emërim Personeli Akademik" të Rektorit të UV, përcjellë me shkresën "Përcjellje vendimesh" me Nr 1623/8 Prot, datë 03.12.2019, të Drejtorit Eloina Tozaj të Drejtorisë së komunikimit dhe Burimeve Njerëzore,
- referuar Vendimit Nr 6, datë 06.03.2020 "Për Emërim Personeli Akademik i Ftuar" të Rektorit të UV për Semestrin Pranverë 2020,
- referuar Vendimit Nr 11, datë 06.03.2020 "Për Emërim Personeli Akademik i Ftuar" të Rektorit të UV për Semestrin Pranverë 2020,
- referuar marrjes së Lejes së Lindjes së pedagoge Sonila Berdo më 21.11.2019, e cila nuk mund të jetë e angazhuar për të mbyllur detyrimet akademik gjatë semestrit Vjeshtë 2019,
- referuar shkresës "Kthim Përgjigje" të Dekanit të Fakultetit të Ekonomisë me nr 91/29 prot datë 13.11.2019,
- referuar shkresës "Shkresë përcjellëse" të Dekanit të Fakultetit të Shkencave teknike" me nr 450/1 prot, datë 12.11.2019, për angazhimin në mësimdhënie të pedagoge Amali Cipi në programin e ciklit të dytë të studimit në Departamentin e Inxhinjerive dhe Teknologjisë Detare, FSHT për mbulimin e lëndës NAV 450 "Zhvillim dhe manaxhim i projektit industrial",
- referuar shkresës "Njoftim" me Nr 1010/1 Prot, datë 02.07.2020 të Drejtorit Eloina Tozaj të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, mbi ndërprerjen e lejes së lindjes së pedagoge Sonila Berdo dhe rikthimin në punë në datë 03.07.2020

si dhe referuar përcjelljes së shkresave të ngarkesës mësimore për vitin akademik 2019-2020 si me poshte:

- Përcjellje evidencave personale për realizimin e kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020, për personelin akademik me kohë të plotë, Departamenti i Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë me me Nr ~~187/2~~ prot, datë ~~23.12~~/2020.
- "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore finale për vitin akademik 2019-2020, Departamenti I Biznesit" me me nr 187/9 prot, datë 10/12/2020
- Përcjellëse e Evidencës Përmbledhëse Finale për planifikimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik me kohë të plotë të Departamentit të Biznesit, për vitin akademik 2019-2020 me Nr 187/11 prot, datë 10.12.2019
- Përcjellje evidencave personale për planifikimin e kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020, për pedagogët P.Resulaj, A. Cipi, Xh. Agaraj, E. Pjero, E.Bazini me Nr 187/10 Prot, datë 10.12.2019.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

- Përcjellje evidencave personale për planifikimin e kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020, për Departamentin e Biznesit, Nr 187/1 Prot, datë 28.10.2019.
- "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore provizore për vitin akademik 2019-2020" me nr 187 prot, datë 11/10/2019

përcjellim për miratim dhe kryerjen e procedurave të mëtejshme për pagesat e mbingarkesave mësimore:

- Ngarkesën Mësimore të realizuar vjetore për personelin akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2019-2020, Cikli i Parë i Studimeve Bachelor, si dhe Cikli i Dytë i Studimeve Master
- Evidencën Përmbledhëse të realizimit të kohës vjetore të punës për personelin akademik me kohë të plotë, për vitin akademik 2019-2020, Departamenti i Biznesit

Për personelin akademik që tejkalon mbingarkesën mësimore në auditor mbi 200 ore, për vitin akademik 2019-2020 është marrë miratimi për mbingarkesën mësimore në auditor të paguar mbi 200 orë, në shkresat.

- "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore provizore për vitin akademik 2019-2020" me nr 187 prot, datë 11/10/2019
- "Shkresë përcjellëse e ngarkesës mësimore finale për vitin akademik 2019-2020, Departamenti i Biznesit" me nr 187/9 prot, datë 10/12/2020

Për personelin akademik që tejkalon mbingarkesën mësimore në auditor mbi 200 ore jemi bazuar në:

- Sipas gërmës a) të Udhëzimit Nr 37, datë 04.12.2018 asnjë prej pedagogëve nuk ka më shumë se tre lëndë në një semestër përveç lëndeve të njëjta referuar programit mësimor por që janë me kode të ndryshme si BIZ 531 Marrje vendimesh manaxheriale, Master Profesional në Financë, dhe BIZ 535 Marrje vendimesh manaxheriale, Master i Shkencave në Administrim Biznesi. Lënda hapet me fillimin e Vitit të Ri Akademik në Mës "Administrim Biznesi" viti i dytë, krahasuar me Masterin Profesional në Financë që hapet dy javë më vonë për shkak të mbylljes së procedurave të aplikimit dhe shpalljes së vendimit të fituesave për studentët që kanë aplikuar në ciklin e dytë të studimeve. Përfundimisht tjetër bën pedagogu Rezarta Hasanaj të cilës ishin planifikuar tre lëndë në semestrin Vjeshtë 2019 dhe tre lëndë Pranverë 2020, ku njëra prej tyre "Sipërmarrje manaxhim Biznesi i Vogël" ishte lëndë e dhënë në semestrin Vjeshtë 2019 dhe Pranverë 2020. Gjatë periudhës së pandemisë, ku mësimi zhvillohej online, studentët e Masterit Profesional Administrim Publik nga tre lëndë me zgjedhje të afishuara në orarin Pranverë 2020, ku dy ishin me kodin BIZ dhe një me kodin ECN,



UNIVERSITETI ISMAIL QEMALI VLORE
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I BIZNESIT

zgjedhën dy lëndë me Kodin BIZ, të cilat u mbuluan nga Pedagogë Rezarta Hasanaj, pavarësisht se nuk ishin planifikuar dy lëndë për tu mbuluar nga pedagogia por vetëm njëra prej tyre në ngarkesën mësimore finale për vitin akademik 2019-2020, evidencën personale dhe përmbledhëse të planifikimit të kohës vjetore të punës për vitin akademik 2019-2020. Në një situatë të tillë të krijuar për shkak të pandemisë, si dhe referuar faktit që e njëjta lëndë “Sipërmarje manaxhim Biznesi i Vogël” është dhënë nga pedagogia në dy semestra të ndryshme, konkludojmë që pedagogë Rezarta Hasanaj ka zhvilluar 6 lëndë të ndryshme në një vit akademik duke iu përmbajtur Udhëzimit Nr 37, datë 04.12.2018.

- Pedagogët që mbulojnë orët e mësipërme janë të kualifikuar dhe specializuar në fushën e mësimdhënies dhe kanë një eksperiencë shumëvjeçare në të.
- Impenjimi dhe përgjegjshmëria e personelit efektiv është shumë e lartë.
- Përmbushet raporti student-pedagog sipas përcaktimeve ligjore. (V.K.M nr. 418 datë 10.05.2017)
- Regjistrimet e reduktuara të studentëve në vit të parë, për disa vite me radhë, kanë ulur numrin e kurseve dhe grupeve mësimore, duke shkaktuar rënie në ngarkesën mësimore që mbulon cdo department. Jemi kështu në kushtet e rasteve specifike të Udhëzimit Nr.29 dt. 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e Arsimit të Lartë” të MASR, Kreu II Pika 1, ku thotë: në raste specifike me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe me miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË BIZNESIT
Prof.Assoc Xhiliola Agaraj (Shehu)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEKANI

Nr. 369 / Prot
13

Datë 26 . 10 2020

Lënda: Përcjellje e mbingarkesave mbi 200 orë mësimore.

PROF.DR.ROLAND ZISIT, REKTOR I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE

Këtu

Për dijeni: Prof.As.Frosina Londos (Qyrdetit), ZV/Rektor Akademik
Drejtorisë së Edukimit të Ciklit të I-rë dhe të II-të

Këtu


I nderuar Z. Rektor,

Po Ju përcjellim shkresat e përgjegjësve të departamenteve të Fakultetit të Shkencave Humane për mbingarkesat mësimore mbi 200 orë për personelin akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2019 – 2020, si më poshtë vijon:

- Departamenti i Drejtësisë
- Departamenti Edukimit
- Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.
-

Bashkëngjitur shkresat përkatëse.

DEKAN
Prof. As. Armela Panajoti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

Nr. 364 Prot.

Vlorë, më 26.10.2020

Lënda: Justifikim për mbingarkesat individuale mbi 200 orë vjetore në Departamentin e Drejtësisë, për vitin akademik 2019-2020, sipas Udhëzimit të MASR nr. 29/2018.

DEKANIT PROF. AS. ARMELA PANAJOTI
Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti 'Ismael Qemali', Vlorë

Referuar Udhëzimit të MASR n. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar) "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", kreu II, pika 1, par. 2, dhe në plotësim të shkresës sonë Nr. 313 Prot., datë 01.10.2020 "Përcjellje e evidencës përmbledhëse dhe e ngarkesës mësimore për personelin akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2019-2020 në Departamentin e Drejtësisë", përcillen justifikimet për orët suplementare në auditor përtej parashikimit specifik prej 200 orësh.

1. **Dr. Arjana Llano:** ngarkesa e detyruar 165 orë – ngarkesa e realizuar në auditor 375 orë - mbingarkesa përtej 200 orëve = 10 orë. Për shkak të angazhimit të koleges në fjalë vetëm në tri lëndë semestrale për të gjithë vitin akademik (E drejtë romake: 2 grupe dhe Histori e Shtetit dhe e së drejtës: 1 grup), konsideruar edhe mungesën e as/lektorëve në këto fusha, është menduar që studentët të kishin mundësinë të ndiqnin edhe seminarët me të njëjtin lektor. Për vitin e ardhshëm akademik që përkon me çeljen e programit të rit ë studimeve të integruara "Master i shkencave" në "Drejtësi", lënda *E drejtë romake* është riformatuar duke u ulur ndjeshëm ngarkesa për lektoren në fjalë. Konsideruar sa më sipër është menduar të konsiderohet si **rast specifik** në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018;
2. **Dr. Besjana Petanaj (Muka):** ngarkesa e detyruar 82,5 orë – ngarkesa e realizuar në auditor 285 orë - mbingarkesa përtej 200 orëve = 2.5 orë. Për shkak të largimit me leje lindje gjatë periudhës korrik 2019 - janar 2020, ngarkesa e detyruar ka qenë në masën 50%. Rasti është specifik pasi ngarkesa totale e realizuar në auditor, në rast të mungesës së lejes së lindjes do të tejkalonte nuk do të tejkalonte absolutisht kufirin prej 200 orësh suplementare (285-165= 120 orë suplementare < 200). Konsideruar sa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

më sipër është menduar të konsiderohet si **rast specifik** në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018;

3. **PhD Erjon Hitaj:** ngarkesa e detyruar **90 orë** (Drejtues i njësisë bazë) – ngarkesa e realizuar **345 orë** – mbingarkesa përtej 200 orëve = **55 orë**. Kjo mbingarkesë vjen për shkak të zhvillimit të lëndës **DRE 522 Diplomaci** (75 orë në auditor), e përfshirë në programin e vjetër Master i shkencave në Marrëdhënie ndërkombëtare. Prej këtij viti akademik kjo lëndë nuk është e përfshirë në programin e rishikuar dhe të përditësuar Master i shkencave në Marrëdhënie ndërkombëtare. Konsideruar sa më sipër është menduar të konsiderohet si **rast specifik** në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018;
4. **Dr. Eriola Cakrani:** ngarkesa e detyruar **165 orë** – ngarkesa e realizuar **390 orë**, nga të cilat 210 orë seminare – mbingarkesa përtej 200 orëve = **25 orë**. Lektor i në fjalë mbulon dy lëndë në programin Bachelor (DRE 245 dhe DRE 321) dhe një lëndë në programin Master profesional në Shkenca administrative (DRE 401). Të gjitha seminarët e lëndëve në fjalë janë mbuluar nga vetë lektori për shkak të pamundësisë për të angazhuar lektorë të jashtëm. Marrë parasysh kontributin e rëndësishëm institucional në grupet e punës të ngritura në departament është menduar të konsiderohet si **rast specifik** në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018;
5. **Dr. Jonida Mehmetaj:** ngarkesa e detyruar **165 orë** – ngarkesa e realizuar në auditor **420 orë** – mbingarkesa përtej 200 orëve = **55 orë**. Kjo mbingarkesë vjen për shkak të zhvillimit të lëndës **DRE 523 Menaxhim krizash** (75 orë në auditor), e përfshirë në programin e vjetër Master i shkencave në Marrëdhënie ndërkombëtare. Prej këtij viti akademik kjo lëndë nuk është e përfshirë në programin e rishikuar dhe të përditësuar Master i shkencave në Marrëdhënie ndërkombëtare. Marrë parasysh kontributin e rëndësishëm institucional në grupet e punës të ngritura në departament, është menduar të konsiderohet si **rast specifik** në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018;
6. **Dr. Stela Meçaj:** ngarkesa e detyruar **165 orë** – ngarkesa e realizuar në auditor **435 orë**, nga të cilat 210 orë seminare – mbingarkesa përtej 200 orëve = **70 orë**. Kjo mbingarkesë vjen për shkak të mbulimit të paparashikuar nga ana e lektorit në fjalë të seminareve të lëndës **DRE 141 E drejtë kushtetuese** (60 orë) dhe seminareve të lëndës **DRE 482 E drejtë mjedisi** (15 orë), të parashikuara fillimisht për t'u mbuluar nga kolegë të tjerë. Marrë parasysh kontributin e rëndësishëm institucional në grupet e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

punës të ngritura në departament, është menduar të konsiderohet si **rast specifik** në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018.

Nga sa më sipër, në rang departamenti, evidentohet një mbingarkesë me orë suplementare në auditor në masën **217.5 orë**. Nga evidenca përmbledhëse e orëve suplementare në auditor, brenda limitit prej 200 orësh, për të gjithë njësinë bazë rezultojnë gjithsej **962.5 orë më pak** se kufiri i lejuar.

Për arsyet e mësipërme është menduar që, edhe në respekt të ruajtjes së raportit lektorë me kohë të plotë/lektorë me kohë të pjesshme, në raste specifike në kuptimin e Kreut II, pika 1, par. 2 i Udhëzimit nr. 29/2018, kolegët e sipërpërmendur janë angazhuar me orë suplementare përtej kufirit prej 200 orësh, por jo më tepër se 100 orë mbi këtë kufi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Drejtues i Departamentit

PhD. Erjon Hitaj

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT

Nr. 367/1 Prot.

Vlorë, më 16.10 2020

Lënda: Justifikim për mbingarkesat individuale mbi 200 orë vjetore në Departamentin e Edukimit, për vitin akademik 2019-2020

DEKANIT PROF. AS. ARMELA PANAJOTI
Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti 'Ismail Qemali', Vlorë

Referuar Udhëzimit të MASR n. 29, datë 10.09.2018 (i ndryshuar) "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", kreu II, pika 1, par. 2, përcillen justifikimet për orët suplementare në auditor përtej parashikimit specifik prej 200 orësh.

1. MSc. Gentiana Xhelili: ngarkesa e detyruar 165 orë – ngarkesa e realizuar në auditor 375 orë - mbingarkesa përtej 200 orëve = 10 orë. Për shkak të nevojave të departamentit dhe mungesën e as/lektorëve në fushën e mbuluar nga pedagogu, është menduar që studentët të kishin mundësinë të ndiqnin edhe seminarët me të njëjtin lektor.
2. PhD Ilva lamaj: ngarkesa e detyruar 165 orë – ngarkesa e realizuar në auditor 495 orë - mbingarkesa përtej 200 orëve = 130 orë. Lektorit në fjalë mbulon tre lëndë në programin Bachelor dhe tre lëndë në programin Master profesional dhe Master Shkencor. Të gjitha seminarët e lëndëve në fjalë janë mbuluar nga vetë lektori për shkak të pamundësisë për të angazhuar lektorë të jashtëm duke marrë parasysh profilizimin e lektorit në fjalë në fushën e Komunikimit si rast specifik.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Drejtues i Departamentit

(PhD. Ilva Lamaj)

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHË-LETËRSISË

Nr. 364/2 Prot.

Vlorë, më, 26 . 10 . 2020

Lënda: Propozim për ngarkesë mbi 200 orë në auditor

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE HUMANE
PROF.AS.DR ARMELA PANAJOTIT

Bazuar në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", referuar pikës II.1. të këtij udhëzimi, propozoj që, për nevoja të departamentit, personeli akademik me kohë të plotë të mbulojë orë në auditor mbi limitin 200 orë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emër mbiemër	Numri i orëve mbi 200
1	Monika Hasani	20 orë
2	Bardhosh Gace	10 orë
6	Migena Balla	10 orë

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT

Prof.as. Monika Hasani



Handwritten signature



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEKANI

Nr 313/4 Prot

Datë 18 . 10 2020

Lënda: Evidencat e orëve mësimore.

1535/2

13.10

PROF.DR.ROLAND ZISIT, REKTORIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI",
VLORE

I nderuar Z. Rektor,

Po Ju përcjellim evidencat përmbledhëse dhe ngarkesat mësimore për personelin akademik me kohë të plotë për vitin akademik 2019-2020 pranë Fakultetit të Shkencave Humane.

Bashkëngjitur dokumentacioni përkatës.

Handwritten signature: Shkencave
Handwritten signature: Roland Zisiti

DEKAN
Prof. As. Armela Panajoti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Nr. _____ prot.

Vlorë, më 05. 10. 2020

Lënda: Për miratim mbingarkese, Departamenti i Gjuhëve të Huaja

PROF. AS. DR. ARMELA PANAJOTI, DEKANE E FSHH-së

Këtu

Për dijeni: Prof. Dr. Roland Zisit, Rektor i UV-së

I nderuar Z. Dekan,

